



UNION INTERNATIONALE DU NOTARIAT

Le Secrétaire

Zoti Ministër i Drejtësisë
Së Republikës së Kosovës
PRISHTINË

Dossier : IHN/UINL
Nos réf. : PB
Vos réf. :

CLARET, 6 KORRIK 2011

Zoti Ministër,

Në pajtim me udhëzimin administrativ No7/2010 mbi provimin e noterisë, kemi bërë mbikëqyrjen e korigjimit të testeve me shkrim të kandidatëve për noter të Republikës së Kosovës. Korigjimet u zhvilluan me 2 dhe 3 korrik 2011, në Prishtinë, në sallat e Ministrisë së Drejtësisë.

Mund të vërtetojmë se të dy ditët kanë kaluar në harmoninë më të mirë të mundshme në mes anëtarëve të pranishëm të Komisionit për provim dhe ne vetë.

Dy grupe korigjuesë janë formuar, secili i përbërë nga së paku dy anëtarë të Komisionit vendor dhe të një ekspert të UINL, korigjimet ishin të bazuar në modalitetet të vendosur parapriakisht së bashku, në pajtim me ekspertet e I-H-N.

Testi i parë i korigjuar ishte testament i cili duhej përpiluar, i dyti ishte testi lidhur me përpilimin e një kontrate shitblerje.

Përshtypja e përgjithshme ishte konstatimin i një përmirësimi të cilësisë së testeve në krahasim me ato të korigjuar në prill të kaluar, sa në formë po aq edhe në përmbajtjen. Trajnimi i fundit i kandidatëve nga I-H-N, në fillim të qershorit, padyshim ka përmirësuar sensin e përgjegjësisë të këtyre!

Shumë pak teste kanë qenë objekt diskutimi, në mes dy grupeve, të nevojshme në rast mëdyshe.

Rezultatet janë të kënaqshëm : nga 99 kandidatë, 43 janë pranuar për provimin me gojë. Kjo është shumë inkurajuese dhe nuk kemi dyshime që praktika e cila do të mbahet në një zyre të trajnimit, β-Office, do të mundësoj ushtrimin e mirë të aktivitetit noterial.

Jemi të lumtur që morëm pjesë në vendosjen e një institucioni kaq të rëndësishëm për ne në një shtet ligjor, dhe kuptohet që mbesim në dispozicionin tuaj në të ardhmen.

Pranoni, Zoti Ministër. nderimet e tona më të sinqerta.

Pierre Becqué

e-mail : pierre.becque.uinl@notaires.fr

UINL Secrétariat : Via Flaminia 158 – Pal. A 00196 ROMA-Italia – Tel : +39-06-3208384 – Fax : +39-06-36091499

e-mail: uinl@uinl.org – http://www.uinl.org